

RAPORT MONITORIMI



Vlerësimi i aktivizimit të Grupit të Gjelbër pranë Kuvendit të Shqipërisë

Periudha shtator 2024 – Mars 2025

Akademia e Studimeve Politike

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins Hyrja 1, kati 7, Ap. 21, Tiranë,
Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al, Web: www.asp.al

I. HYRJE

Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor është një strategji e re për zhvillimin e rajonit që kalon nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme, në përputhje me Agjendën e Gjellbër Evropiane. Duke nënshkruar Deklaratën mbi Agjendën e Gjellbër, vendet e Ballkanit Perëndimor u angazhuan në Samitin e Sofjes më 10 nëntor 2020 për të zbatuar masa ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të energjisë, transportit dhe ekonomisë qarkulluese, si dhe mbrotjes së biodiversitetit, bujqësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm.

Me synim rritjen e njohurive dhe bashkëpunimit të parlamentarëve me aktorë të ndryshëm institucionalë dhe civilë për zbatimin e objektivave të ndërmarra në kuadër të Agjendës së Gjellbër, pranë Kuvendit të Shqipërisë është themeluar Grupi i Gjellbër.

Grupi i Gjellbër është krijuar me urdhërin nr. 55 datë 16.06.2022 të Kryetares së Kuvendit, është konstituuar më 20 korrik 2022 dhe ka plotësuar strukturat e tij në shtator 2022. Në përbërje të tij ka deputetë të grupeve të ndryshme parlamentare dhe të komisioneve parlamentare, të cilët kanë në fokus të punës së tyre politikat e Bashkimit Europian mbi sektorin e energjisë, të transportit dhe mjedisit.

Pas disa ndryshimeve që ka pësuar përbërja e tij si pasojë e dorëzimit të mandatit të deputetit nga disa deputetë, apo emërimit në ekzekutiv të një deputeteje, aktualisht Grupi përbëhet nga 29 deputetë, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në nxitjen e përmbushjes së detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Agjendës së Gjellbër.

Falë koordinimit të Akademisë së Studimeve Politike (ASP), anëtarët e Grupit të Gjellbër janë angazhuar në nisma dhe bashkëpunime me parlamentarët në rajon mbi zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë, mobilitetin urban dhe ndryshimet klimatike. Ky bashkëpunim rajonal mundësohet nga Qeveria Gjermane dhe Komisioni Evropian, në kuadër të Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore-Energjisë, Transportit dhe Mbrojtjes së Klimës (ORF-ETC), i cili zbatohet bashkërisht nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Rrjeti i Shkollave të Studimeve Politike në Ballkanin Perëndimor.

II. VLERËSIMI PERIODIK I DEPUTETËVE TË GRUPIT TË GJELBËR

Nga momenti i kostituimit të Grupit të Gjelbër e deri tani me mbështetjen e ASP janë organizuar disa aktivitete me qëllim ofrimin e ekspertizës për rritjen e njohurive të deputetëve dhe nxitjen e bashkëpunimit të tyre me parlamentarët e rajonit mbi zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë, mobilitetin urban dhe ndryshimet klimatike.

Deputetët e Grupit të Gjelbër luajnë një rol kyç në çështjet që lidhen me Agjendën e Gjelbër, si dhe në rritjen e përgjegjshmërisë mjedisore dhe në promovimin e praktikave më të mira dhe në angazhimin afatgjatë.

ASP, e bindur në rëndësinë e vlerësimit të performancës së këtij Grupi, ka kryer një vlerësim të aktivitetit të deputetëve anëtarë të Grupit të Gjelbër për periudhën korrik 2022 – 1 korrik 2024.

Nisur nga rezultatet e këtij vlerësimi dhe rëndësinë e tij në përmirësimin e performancës së Grupit për një mjedis të qëndrueshëm, mbështetjen e politikave të gjelbra dhe adresimin e çështjeve që lidhen me ndryshimet klimatike, ASP vendosi ta vijojë vlerësimin edhe për periudhën shtator 2024 – mars 2025 e bindur se vlerësimi periodik i deputetëve është një proces themelor i një sistemi demokratik të fuqishëm dhe është shumë i rëndësishëm për:

III. STRATEGJIA E PROCESIT TË VLERËSIMIT

Zbatimi i një kornize të strukturuar të vlerësimit siguron që deputetët të mbeten të përkushtuar ndaj përgjegjësisë të tyre legjislative dhe përfaqësuese, duke nxitur një sistem politik më të përgjegjshëm dhe efektiv. Në veçanti, vlerësimi i deputetëve që angazhohen për objektivat e Agjendës së Gjelbër, është thelbësor për të garantuar që politikat klimatike dhe të qëndrueshmërisë mjedisore po zbatohen me efektivitet. Kjo ndihmon në ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt dhe të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Për të siguruar një vlerësim efektiv, ASP ka vendosur të ndjekë të njëjtën strategji si në vlerësimin paraardhës e cila bazohet në:

- tregues të qartë e të matshëm performance të vendosur në vlerësimin e parë, ku pavarësisht dëshirës për t'i zgjeruar ato edhe me veprimtarinë publike të deputetëve, do të vazhdojnë të jenë të njëjtat;
- vlerësimin e aktivitetit si mbi sistem pikëzimi ashtu edhe në analizë;
- hartimin e skendës personale për tre deputetët më aktivë;
- prezantimin e këtij vlerësimi në një aktivitet të Grupit të Gjelbër; si dhe

- publikimin e këtij raporti vlerësimi të performancës për publikun në faqen e saj zyrtare dhe në media.

IV. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Metodologjia e përdorur mbetet e njëjtë me metodologjinë e përdorur në vlerësimin e parë të performancës së deputetëve të Grupit të Gjelbër, për aq sa veprimtaria e tyre parlamentare lidhet me çështjet e përfshira në Agjendën e Gjelbër që fokusohen kryesisht në nxitjen e marrjes së masave ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të sektorit të energjisë, transportit dhe ekonomisë qarkulluese, si dhe mbrotjes së biodiversitetit, bujqësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm.

Kjo metodologji ka përzgjedhur disa prej 11 elementëve kryesorë të angazhimit të deputetëve të Grupit të Gjelbër me fokus në tranzicionin energjetik dhe Agjendën e Gjelbër, të cilët kanë një angazhim të veçantë për të siguruar që politikat kombëtare përputhen me objektivat për një mjedis më të pastër dhe një zhvillim të qëndrueshëm. Vlerësimi i tyre përfshin:

1. **Kontributin në politikat klimatike.** Vlerësimi i iniciativave të propozuara për reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.
2. **Mbështetjen për energjitë e rinovueshme.** Monitorimi i angazhimit për promovimin e burimeve të pastërta të energjisë dhe uljen e varësisë nga lëndët djegëse fosile.
3. **Pjesëmarrja në debatin ekologjik.** Analizimi i përfshirjes së tyre në diskutimet mbi çështjet e qëndrueshmërisë dhe ndryshimeve klimatike.
4. **Ndikimi në politikat lokale dhe kombëtare.** Vlerësimi i masave të ndërmarra për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në nivel komuniteti dhe kombëtar.

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e deputetëve të Grupit të Gjelbër fokusohet në diskutimet në komisionet parlamentare dhe në seancat plenare; pyetjet e drejtuara në komisionet parlamentare dhe në seancat plenare; interpelancat e kërkuara; amendamentet e bëra në shqyrtimin e akteve ligjore dhe nismat ligjore të propozuara, për sa ato lidhen me çështjet e Agjendës së Gjelbër; çështjet e ngritura nga komuniteti i zonave që përfaqësojnë në seancat e posaçme të javës së gjelbër; veprimtaria e Grupit të Gjelbër duke përfshirë pjesëmarrjen në aktivitetet e tij, diskutimet e pyetjet në këto aktivitete; si dhe ftesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare për çështje që lidhen me Agjendën e Gjelbër dhe adresimi i propozimeve të saj duke e parë si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin mes tyre.

Ndërkohë, pavarësisht dëshirës që në këtë vlerësim të përfshihen edhe element, të cilët lidhen me veprimtarinë e deputetit jashtë agjendës parlamentare, si fushatat ndërgjegjëse në komunitet; veprimtaritë në zonat elektorale; vlerësimet, promovimet, debatet në media sociale e media, etj; ASP gjykoj që edhe për këtë periudhë nuk është e mundur të jenë pjesë e vlerësimit.

Ky vlerësim është fokusuar vetëm tek mbledhja sistematike e të dhënave, analiza dhe përdorimi i informacionit nga veprimtaria ligjvënëse, kontrolluese dhe zgjedhëse parlamentare.

- ***Pikëzimi***

Metodologjia për vlerësimin e aktivizimit të deputetëve të Grupit të Gjelbër është zbërthyer në kriteret dhe pikëzimin si më poshtë:

1. Pjesëmarrja në aktivitetet e Grupit të Gjelbër vlerësohet me 1 pikë për çdo aktivitet;
2. Angazhimi në debate dhe diskutime në aktivitetet e Grupit të Gjelbër, komisionet parlamentare dhe seancat plenare, vetëm për çështje të përfshira në agjendën e gjelbër vlerësohet me 3 pikë për diskutim/debatim;
3. Angazhimi në kontrollin parlamentar në procesin legjislativ dhe atë kontrollues në aktivitete të Grupit të Gjelbër, mbledhjet e komisioneve parlamentare përkatëse dhe në seancë plenare vlerësohet me 2 pikë për çdo pyetje;
4. Angazhimi në kontrollin parlamentar nëpërmjet interperancave në seancat plenare vlerësohet me 4 pikë;
5. Angazhimi për të përfshirë organizatat joqeveritare që operojnë në fushën e mjedisit gjatë shqyrtimit të legjislacionit që lidhen me çështje të Agjendës së Gjelbër në komisione e veprimtaritë të Grupit të Gjelbër, vlerësohet me 2 pikë;
6. Angazhimi në adresimin e shqetësimeve të shoqërisë civile, ekspertëve të lirë dhe akademikëve, vlerësohet me 2 pikë;
7. Angazhimi në propozimin e amendamenteve në komisionet parlamentare apo në seancë plenare në shqyrtimin e nismave që lidhen me çështje të Agjendës së Gjelbër vlerësohet me 4 pikë për çdo amendament;
8. Angazhimi në propozimin e nismave ligjore që lidhen me çështje të Agjendës së Gjelbër dhe mbrojtjen e tyre në komisionet parlamentare vlerësohet me 5 pikë për çdo nismë.

V. VLERËSIMI

A. Raporti i vlerësimit

Vlerësimi i një grupimi të tillë varet nga efektiviteti i tij në nxitjen e politikave të gjelbra dhe nga pengesat që hasin në realizimin e misionit të tij. Në përfundim të mbledhjes së të dhënave dhe procesit të vlerësimit u konstatua se:

1. Deputetët më aktivë të Grupit të Gjelbër për periudhën nën monitorim janë Xhelal Mziu, Arben Pëllumbi, Lefter Gështenja, Emilja Koliqi, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Laert Duraj, Ramadan Likaj, Blerina Gjylameti dhe Helidon Bushati.
2. Nga aktivizimi sipas fushave të përgjegjësisë së Komiteteve të Grupit të Gjelbër:
 - në çështjet e mjedisit dhe klimës, deputetët më aktivë janë deputetët, Arben Pëllumbi, Ismet Beqiraj dhe Luljeta Bozo;
 - në çështjet e bujqësisë deputetët më aktivë janë Ramadan Likaj, Agron Duka, Emilja Koliqi, Fadil Nasufi, Baftjar Zeqaj dhe Dashnor Sula.
 - në çështjet e energjisë deputetët më aktivë janë Blerina Gjylameti, Laert Duraj dhe Xhelal Mziu;
 - në çështjet e transportit deputetët më aktivë janë Emilja Koliqi, Lefter Gështenja, Xhelal Mziu dhe Arben Pëllumbi.
 - Në angazhimin rajonal të Grupeve të Gjelbra të Ballkanit Perëndimor deputeti më aktiv është Ferdinand Xhaferaj.
3. Sa i përket barazisë gjinore, nga ky vlerësim konstatohet se ndër deputetet gra anëtare të Grupit të Gjelbër si më aktivet janë vlerësuar Znj. Emilja Koliqi, Znj. Blerina Gjylameti, Znj. Luljeta Bozo dhe Znj. Sorina Koti.
4. Sipas shtyllave të Agjendës së Gjelbër, angazhimi më i madh i deputetëve është në çështjet e bujqësisë (282 pikë), në çështjet e mjedisit e klimës (231 pikë), në çështjet e transportit (250 pikë) dhe në fund çështjet e energjisë (62 pikë) që janë më pak të diskutuarat.

Më poshtë renditja e deputetëve sipas pikëve

Nr.	Deputeti	Mjedis / Klima	Energji	Transport	Bujqësi	Total
1	Xhelal Mziu	3	11	37	37	88
2	Arben Pëllumbi	34	3	27	16	80
3	Lefter Gështenja	14	3	38	17	72
4	Emilja Koliqi	10		39	22	71
5	Fadil Nasufi	21	6	19	21	67
6	Ismet Beqiraj	34		13	16	63
7	Laert Duraj	27	17	3	6	53
8	Ramadan Likaj	3		9	29	51
9	Blerina Gjylameti	3	13	16	12	44
10	Helidon Bushati	5		10	18	33
11	Baftjar Zeqaj	3	3		18	24
12	Agron Duka	3			18	21
13	Luljeta Bozo	18			3	21
14	Dashnor Sula	3			18	21
15	Ferdinant Xhaferaj			21		21
16	Sorina Koti	3			16	20
17	Nusret Avdulla	17				17
18	Enslemvera Zake			6	10	16
19	Ilir Ndraxhi	6		6		12
20	Eduard Shalsi	9			3	12
21	Petro Koçi	11				11
22	Anduel Tahiraj			6	4	10
23	Ilirian Pendavinji		6			6
24	Ina Zhupa	4				4

B. Konstatime të tjera nga analiza e vlerësimit

Përveç vlerësimit të mësipërm, nga ky proces vlerësimi u konstatuan edhe çështje të tjera si:

1. Deputetët më aktivë janë deputetët anëtarë të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, por nga procesi i vlerësimit është konstatuar se shumica e çështjeve që janë në fokus të këtij vlerësimi janë shqyrtuar si tek ky Komision, ashtu edhe tek Komisionet e tjerë ku bëjnë pjesë deputetët e Grupit të Gjellbër, si edhe në seancat plenare.

2. Angazhimi është ushtruar kryesisht me anë të pyetjeve (188 pyetje) dhe diskutimeve (166 diskutime), ndërkohë që elementet e tjera të vlerësimit janë shumë të pakta.
3. Periudha e vlerësimit u shënua nga një veprimtari e ulët parlamentare për shkak të mosfunksionimit normal të kësaj veprimtarie për një periudhë kohe pothuaj 2 muaj (shtator – tetor 2024), si dhe për shkak të periudhës parazgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme 11 Maj 2025.
4. Në ndryshim nga vlerësimi i parë, për periudhën aktuale të vlerësimit nuk ka pasur aktivitete të veçanta të Grupit të Gjelbër të organizuara në bashkëpunim me shoqërinë civile e organizma të tjerë.
5. Përveç se në seancën mujore të posaçme për problematikat e zgjedhësve (*java e gjelbër*), edhe gjatë veprimtarisë ligjvënëse dhe sidomos në procesin e miratimit të buxhetit, dhe veprimtarisë kontrolluese (*pyetje/interpelanca*) është konstatuar se deputetët janë shumë të ndjeshëm dhe kërkues ndaj përfaqësuesve të ekzekutivit për fenomene e projekte nga zonat e tyre zgjedhore që lidhen me angazhimet e Agjendës së Gjelbër.
6. Përveç anëtarëve të Grupit të Gjelbër, u identifikuan edhe disa deputetë aktivë në çështjet e Agjendës së Gjelbër. Këtu mund të përmendim deputetët **Edona Bilali**, e cila ka propozuar një nismë ligjore në legjislacionin për fondin kullosor në mbështetje të shtimit të energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme dhe lehtësimit të furnizimit me energji në vend, **Erion Braçe**, i cili ka kontribuar me një nismë ligjore për rishikimin e TVSH-së në bujqësi dhe në nxitjen e çështjeve që lidhen me bujqësinë, **Jorida Tabaku**, **Luan Baçi**, etj.
7. Në raport me vlerësimin e mëparshëm, duke pasur parasysh edhe periudhën kohore që është shumë më e shkurtër se periudha e vlerësimit të mëparshëm, vihet re se deputetët janë më të ndërgjegjësuar dhe se janë më të fokusuar në çështjet që lidhen me Agjendën e Gjelbër.

C. Analiza e diskutimeve kryesore në procesin ligjvënës

Nga ky vlerësim është konstatuar se deputetët kanë qenë më aktivë në angazhimet e Agjendës së Gjelbër si më poshtë:

- ***Angazhimi nr. 1: “Dekarbonizimi dhe energjia e pastër”.*** Ky angazhim fokusohet tek rritja e investimeve në energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin energjetik; kufizimi i

projekteve që dëmtojnë ekosistemet natyrore; zhvillimi i politikave për reduktimin e emetimeve të karbonit deri në vitin 2030. Në kuadër të këtij angazhimi deputetët janë angazhuar në shqyrtimin dhe miratimin e nismës së deputetes Bilali për projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9693/2007 “Për fondin kullosor”” i cili hap rrugë shfrytëzimit të kullorave edhe për prodhimin e energjisë nga dielli dhe era duke kontribuar kështu në rritjen e investimeve në energjitë e rinovueshme..

- **Angazhimi nr. 2: “Menaxhimi i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese”.** Ky angazhim fokusohet tek përmirësimi i politikave të riciklimit dhe kufizimi i ndotjes nga plastika; hartimi i një strategjie kombëtare për riciklimin dhe zvogëlimin e mbetjeve; rritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe industriale. Në kuadër të këtij angazhimi deputetët janë angazhuar në shqyrtimin e projektligjit “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje” (akoma në proces shqyrtimi), i cili përcakton përgjegjësitë e subjekteve prodhuese/importuese për menaxhimin e mbetjeve të produkteve të prodhuara/tregtuara prej tyre duke lehtësuar kështu menaxhimin e mbetjeve në vend. Gjithashtu, janë përfshirë në diskutime edhe për ashpërsimin e penaliteteve në legjislacionin e mbetjeve bazuar në parimin ndotësi paguan.
- **Angazhimi nr. 3: “Mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve”.** Ky angazhim fokusohet tek shtrirja dhe mbrojtja e zonave të mbrojtura natyrore; hartimi i politikave për ndalimin e hidrocentraleve në lumenjtë me vlerë të lartë ekologjike; luftimi i ndërtimeve të paligjshme dhe shpyllëzimit. Në kuadër të këtij angazhimi deputetët janë angazhuar në diskutime mbi një paketë prej shumë ligjesh si ai i mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes së biodiversitetit, mbrojtjes së cilësisë së ajrit, lejet e mjedisit e vlerësimit mjedisor duke miratuar rritjen e penaliteteve për shkelësit e këtyre normave ligjore..
- **Angazhimi nr. 4: “Bujqësia e qëndrueshme dhe siguria ushqimore”.** Ky angazhim fokusohet tek mbështetja e fermerëve që përdorin praktika ekologjike dhe organike; reduktimi i pesticideve dhe promovimi i prodhimit të qëndrueshëm bujqësor; krijimi i tregjeve lokale për produkte bio. Në kuadër të këtij angazhimi deputetët janë angazhuar në diskutime gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme si ai “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” dhe ai “Për shëndetin e bimëve” të cilët synojnë reduktimin e pesticideve të përdorura dhe kontrollin më të mirë të tyre. Gjithashtu, sa i përket bujqësisë organike dhe krijimit të tregut lokal për produktet BIO, deputetët janë angazhuar në diskutime gjatë shqyrtimit të projektligjit për “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre” i cili zbatohet për produktet me origjinë nga bujqësia, përfshirë akuakulturën, bletarinë dhe produktet e prejardhura prej tyre. Deputetët kërkuar nga përfaqësuesit e

qeverisë që të jepet më shumë mbështetje financiare për fermerët që po shkojnë drejt prodhimit organik. Sa i përket sigurisë ushqimore, gjatë shqyrtimit të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, pikërisht në kuadër të sigurisë ushqimore dhe duke marrë shkas edhe nga shoqatat e veterinerëve, deputetët debatuan dhe vendosën që, substancat aktive të prodhimit të medikamenteve të trajtimit të kafshëve, të importoheshin vetëm nga vendet e BE-së dhe ato të prodhuara në vendet e treta me të cilat Bashkimi Evropian ka nënshkruar marrëveshje të njohjes së ndërsjellë.

- **Angazhimi nr. 5: “Transporti dhe urbanizimi i qëndrueshëm”.** Ky angazhim fokusohet tek zhvillimi i rrjeteve të transportit publik ekologjik dhe infrastrukturës për biçikleta; rritja e subvencioneve për automjetet elektrike dhe ndërtimi i stacioneve të karikimit; shtimi i hapësirave të gjelbra urbane dhe masa për uljen e ndotjes së ajrit. Në kuadër të këtij angazhimi, deputetët janë angazhuar në procesin ligjvënës gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit 2025 duke kërkuar më tepër fonde për pushtetin vendor që ai të përmbushë detyrimet e tij për një transport me standarde, apo duke kërkuar akse urbane me standarde të pranueshme mjedisore në zonat e tyre.

Aneks – Përbërja e Grupit të Gjellbër

Grupi i Gjellbër përbëhet nga deputetët:

Agron Duka	Tatjana Piro
Anduel Tahiraj	Xhelal Mziu
Anila Denaj	Eduard Shalsi
Arben Pëllumbi	Erisa Xhixho
Baftjar Zeqaj	Petro Koçi
Enslemvera Zake	Blerina Gjylameti
Fadil Nasufi	Ilirian Pendavinji
Helidon Bushati	Ervin Salianji
Ilir Ndraxhi	Dashnor Sula
Ismet Beqiraj	Ferdinand Xhaferaj
Laert Duraj	Sorina Koti
Lefter Gështenja	Emilja Koliqi
Luljeta Bozo	Orjola Pampuri
Nusret Avdulla	Ina Zhupa
Ramadan Likaj	

Kryetar i Grupit është zgjedhur z. Arben Pëllumbi dhe deputetët janë të ndarë në 3 Komitete si më poshtë:

- Komiteti për Çështjet e Energjisë, i kryesuar nga Helidon Bushati;
- Komiteti për Transportin dhe Mobilitetin, i kryesuar nga Ferdinand Xhaferaj;
- Komiteti për Mjedisin dhe Klimën, i kryesuar nga Eduard Shalsi.

Përkatësia sipas komisioneve parlamentare ku bëjnë pjesë këta deputetë është si më poshtë:

- Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin 15 deputetë;
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut 3 deputetë;
- Komisioni për Ekonominë dhe Financat 6 deputetë;
- Komisioni për Politikën e Jashtme 1 deputet;
- Komisioni për Sigurinë Kombëtare 1 deputet;
- Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë 2 deputetë; dhe
- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik 1 deputet.

Skedat për deputetët

Xhelal Mziu

KRITERI	PIKËT	FOKUSI	ARGUMENTIM
Pjesëmarrja në mbledhje/ aktivitete (1)			
Diskutimi në komisione/seancë (3)	3	Transport	Diskutim në komision ek. dt. 23.7.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për linjën hekurudhore Vorë – Hani i Hotit – Porta globale”. Mbështetje dhe kërkesa për zbatimin e projektit.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 4.9.2024 për projektligjin për veterinarinë. Diskutoi për mbështetje më të madhe për bujqësinë.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision ek. dt. 16.9.2024 për projektligjin “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”. Mbështetje për prodhimin bujqësor organik vendas.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 11.11.2024 për projektbuxhetin 2025 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Kërkesë për mbështetje më të madhe për një bujqësi të qëndrueshme.
	3	Bujqësi	Diskutim në komisionin e ekonomisë dt. 27.11.2024 për projektbuxhetin, ku kërkon rishikimin e TVSH 20% për fermerët e vegjël si mbështetje për prodhimin vendas.
	3	Transport	Diskutim në komision dt. 10.12.2024 për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare, sh.a.” Mbështetje për

			infrastrukturën dhe problematikat e realizimit të veprave.
	3	Mjedis	Diskutim në komision në dt. 19.2.2025 . Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”. Mbështetje për një ambient sa më të pastër, por edhe kërkimi i zgjidhjes optimale për të gjithë aktorët e përfshirë në proces.
	3	Transport	Diskutim në seancë dt 26 korrik 2024 për marrëveshjen e kredisë për ndërtimin e hekurudhës Vorë - Hani i Hotit - Porta Globale. Marrja e kësaj kredie dhe ndërtimi i këtij aksi hekurudhor, jo vetëm për të lidhur një zonë të rëndësishme, siç është Shkodra dhe të gjitha qytetet deri atje, por edhe për ta kthyer Shqipërinë në lidhje ndërkombëtare, duhet mbështetur edhe me pjesën tjetër të infrastrukturës rrugore.
	3	Bujqësi	Diskutim në seancë dt 12 shtator 2024 për aktin normativ të buxhetit ku ndër të tjera kërkon mbështetje për një bujqësi konkurruese e të qëndrueshme.
	3	Transport	Diskutim në seancë dt 30 janar 2025 për me financimin e shtuar për projektin e hekurudhës Durrës – Rinas –Tiranë. Mangësitë në projekt dhe papërgjegjshmërinë e përdorimit të fondeve në një projekt me ndikim kaq të rëndësishëm në transportin hekurudhor.
	3	Bujqësi	Diskutim seancë plenare dt. 18-19 nëntor 2024 gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit 2025. Ne duhej të kishim një paketë fiskale, madje të merrte në konsideratë edhe TVSH-në, që të mos abuzohej me prodhuesit bujqësor në

			terren. Vetëm 0,68% të GDP-së e zë bujqësia, kur më shumë se 500 mijë shqiptarë janë të lidhur me këtë sektor shumë të rëndësishëm, por, në fakt, produktet e tyre janë në konkurrencë të pandershme. Subvencionet që i jepen bujqësisë, janë 5 deri 7 herë më pak sesa ato të rajonit dhe nuk mund të krahasohen me vendet e Europës dhe të Bashkimit Europian.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 25.2.2025 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor””. Kërkoi që projektligji të sillte mbështetjen e merituar për bujqësinë.
	3	Bujqësi	Diskutim në seancë plenare 10 mars 2025 në lidhje me mbështetjen e fermerëve dhe zhvillimin e infrastrukturës së ujitjes në bujqësi, duke mundësuar kështu një bujqësi të qëndrueshme.
	3	Transport/ Energji	Diskutim në komisionin e ekonomisë dt. 8/11/2024 në projektligjin për buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës 2025. Diskutim mbi projektet e ndryshme në transportin rrugor në veri, si dhe të sistemit të matjes së energjisë.
Pyetje në komisione/séancë (2)	18	Transport	Pyetje (9) në komision dt. 23.7.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për linjën hekurudhore Vorë – Hani i Hotit – Porta globale”.
	10	Bujqësi	Pyetje (5) në komision dt. 4.9.2024 për projektligjin për veterinarinë.
	2	Bujqësi	Pyetje (1) në komision ekonomisë dt. 16.9.2024 për projektligjin “Për

			prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”.
	8	Transport	Pyetje (4) në komision dt. 10.12.2024 për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare, sh.a.”
	4	Bujqësi	2 pyetje në seancë plenare dt. 18-19 nëntor 2024 gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit 2025. Në lidhje me mbështetjen buxhetore dhe fiskale të sektorit të bujqësisë.
	4	Bujqësi	Pyetje (2) në komision dt. 25.2.2025 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor””.
	14	Transport/ Energji	Pyetje (7) në komisionin e ekonomisë dt. 8/11/2024 në projektligjin për buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës 2025.
Interpelanca (4)			
Ftesë për dëgjesa të Shoq. Civile (2)			
Amendamente (4)			
Nisma ligjore (5)			

KRITERI	PIKËT	FOKUSI	ARGUMENTIM
Pjesëmarrja në mbledhje/ aktivitete (1)			
Diskutimi në aktivitete/ Komisione/ seancë (3)	3	Transport	Diskutim në komision dt. 16.7.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për linjën hekurudhore Vorë – Hani i Hotit – Porta globale”. Mbështetje për projekte madhore. Më vjen mirë që kemi arritur qoftë aksin e korridorit të Veriut, por edhe aksin e Korridorit 8 t’i kemi në TEN-T, bërthamën e infrastrukturës rrugore europiane, kështu që shpresojmë që këto projekte realisht në vitin 2031 t’i kemi dhe t’i gëzojnë qytetarët dhe trafiku i udhëtarëve dhe i mallrave në Shqipëri.
	3	Mjedis	Diskutim në komision dt. 11.9.2024 për projektligjit “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”.
	3	Mjedis	Diskutim në komision dt. 1/10/2024 për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me Republikën Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2022 për projektin “Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri”. Diskutoi mbi menaxhimin e fenomeneve natyrore dhe ofroi mbështetje që Shqipëria të bëhet pjesë e Rrjetit European të Meteorologjisë.
	3	Transport	Diskutim në komision dt. 15.10.2024 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar”. U shpreh se çështja e mjedisit nuk është vetëm një çështje qeveritare, nuk është vetëm një çështje e pushtetit qendror apo e pushtetit lokal, kjo është një çështje e të gjithëve
	3	Mjedis	Diskutim në komision dt. 6.11.2024 për projektbuxhetin 2025 Ministria e Infrastrukturës

			dhe Transportit. U shpreh se si komision i kemi mbështetur vazhdimisht të gjitha projektet, që kanë të bëjnë me zhvillimet e infrastrukturës në këtë vend, dhe më vjen shumë mirë që më në fund edhe hekurudha po merr rëndësinë e vet. Gjithashtu, boshti europian i rrugëve, qoftë Korridori VIII, Korridori Blu, por qoftë edhe hekurudhat, portet dhe aeroportet, do të kontribuojnë ndjeshëm edhe në atë që është pritshmëria e rritjes së turizmit në Shqipëri.
3	Mjedis		Diskutim në komision dt. 8.11.2024 për projektbuxhetin 2025 Ministria e Mjedisit dhe Turizmit. Diskutim mbi menaxhimin e situatës së mbetjeve në eksport. Krahas rritjes së turizmit, mirëpresim të gjitha nismat ligjore që shkojnë në drejtim të forcimit të rregullave për një mjedis më të pastër e më të qëndrueshëm
3	Transport		Diskutim në komision në dt. 22.1.2025. marrëveshje kredie për “Hekurudhat shqiptare, rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë- Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.
3	Transport		Diskutim në komision e ligjeve në dt. 22.1.2025. marrëveshje kredie për “Hekurudhat shqiptare, rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë- Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.
3	Mjedis		Diskutim në komision në dt. 19.2.2025. Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”. Mbështetje për një ambient sa më të pastër, sa më komod dhe sa më pak të ndotur që të jetë e mundur
3	Bujqësi		Diskutime në séancë dt. 14 nëntor 2024 për Buxhetin Faktik 2023. Eksportet e produkteve si frutat dhe perimet në tregjet e Bashkimit Europian kanë kontribuar në rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe zhvillimin e zonave rurale. Kjo rritje

			ka ndihmuar në zvogëlimin e papunësisë në zonat bujqësore dhe ka përmirësuar standardin e jetesës në këto komunitete
	3	Transporti	Diskutim seancë plenare dt. 18-19 nëntor 2024 gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit 2025. Rrugët kombëtare dhe rajonale, sigurisht projektet për rrugët, si zhvillimi i projekteve të mëdha, ai i Elbasan-Lekaj, bajpasi i Elbasanit dhe zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës, do të ndihmojnë në lehtësimin e qarkullimit dhe në zhvillimin ekonomik të zonave përreth. Vazhdimi i investimit shumë të rëndësishëm të Korridorit VIII, ElbasanPërrenjas, lotet e tjera, përveç atyre që kanë filluar, por edhe rruga Milot-Balldren do të njohë një zhvillim të ri. Jam besimplotë po ashtu që edhe aksi Qukës-Qafë Plloçë do të njohë fillimin e operimit të tij vitin që vjen. Integrimi i sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe europian, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave zhvilluese në fushën e infrastrukturës dhe mjeteve të transportit hekurudhor, mbetet një nga prioritetet e kësaj mazorance.
	3	Bujqësi	Sa i përket sektorit të bujqësisë, ai jo vetëm mbështet një pjesë të madhe të popullsisë sonë, por gjithashtu kontribuon në sigurinë ushqimore dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Në vitin 2025 bujqësia do të financohet në nivelin 0,6% të prodhimit të brendshëm bruto, me synimin për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e këtij sektori.
	3	Mjedis	Diskutim në komision në dt. 10.12.2024 për projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”. Ky ligj, siç e konceptoj unë, është një ligj, i cili synon që të shkojnë sa më pak mbetje, që kanë mundësinë të riciklohen, në vendet e depozitimit të mbetjeve.
	3	Transport	Diskutim në seancë dt. 12 DHJETOR 2024 për krijimin e “administratorit të infrastrukturës hekurudhore”. Projektligji do të mbështesë politikat e qeverisë shqiptare për të ndërtuar një mentalitet

	3		dhe mënyrë bashkëpunimi me institucionet financiare europiane, si: BEI apo BERZH-i, që mundësojnë mbështetje të projekteve madhore të zhvillimit të vendit brenda afateve sa më optimale në konceptim e deri në zbatim, duke respektuar në maksimum standardet më të mira të zbatueshme për projektet madhore e interesat më të mira të shtetasve dhe shteteve europiane në vendet tona.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 10.2.2025 për projektligjin “Paketa e maleve”. Pro zhvillimit të zonave malore.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 25.2.2025 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor””. Diskutim mbi sfidat, arritjet dhe mbështetjen për bujqësinë.
	3	Energji	Diskutim në komision dt. 10.3.2025 për projektligjin “Për shëndëtin e bimëve”. Diskutimi në komision për Raportin vjetor 2024 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të prezantuar nga Drejtori i Sekretariatit Lowkovski në datë 17 mars 2025 . Diskutoi mbi mbështetjen për proceset e energjisë në përgjithësi dhe përafrimin e paketës së tretë rregullatore të BE-së për energjinë.
Pyetje në aktivitete/ Komisione/ seancë (2)	2	Transport	Pyetje (1) në komision dt. 16.7.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për linjën hekurudhore Vorë – Hani i Hotit – Porta globale”.
	2	Bujqësi	Pyetje (1) në komision dt. 16.7.2024 për projektligjin “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për themelimin e Organizatës Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës”
	6	Mjedis	Pyetje (3) në komisionin e ligjeve dt. 30.9.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi bashkëpunimin teknik 2022 për

	2	Mjedis	projektin “Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri”
	4		Pyetje (1) në komision dt. 15.10.2024 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar”.
	8	Mjedis/ Transport	Pyetje (4) në komision dt. 10.2.2025 për projektligjin “Paketa e maleve”. Pro zhvillimit të zonave malore. Pyetje (4) në komision në dt. 19.2.2025 . Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”.
Interpelanca (4)			
Ftesë për dëgjesa të Shoq. Civile (2)	2		Sugjerim: Duke qenë se disa nga rekomandimet e ekspertit prekin edhe fushën e veprimtarisë së projektligjit, Z. Pëllumbi kërkoi nga përfaqësuesit e qeverisë nëse këto gjetje e propozime të tyre janë marrë parasysh në draftin final të projektligjit.
Amendamente (4)			
Nisma ligjore (5)			

Lefter Gështenja

KRITERI	PIKËT	FOKUSI	ARGUMENTIM
Pjesëmarrja në mbledhje/			

aktivitete (1)			
Diskutimi në aktivitete/ Komisione/ seancë (3)	3	Transport	Diskutim në komision dt. 16.7.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për linjën hekurudhore Vorë – Hani i Hotit – Porta globale”. Mbështetje dhe kërkesa për zbatimin e projektit.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 10.9.2024 për projektligji për peshkimin. Interes për procesin e konsultimit publik.
	3	Energji	Diskutim në komision dt. 11.11.2024 për projektbuxhetin 2025 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Kërkesë për mbështetje më të madhe për një bujqësi të qëndrueshme.
	3	Transport	Diskutim në komision dt. 10.12.2024 për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare, sh.a.” Mbështetje për infrastrukturën hekurudhore dhe rëndësinë e saj.
	3	Transport	Diskutim në komision në dt. 22.1.2025 . marrëveshje kredie për “Hekurudhat shqiptare, rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë- Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.
	3	Mjedis	Diskutim në seancë dt 4 korrik 2024 për paketën e ligjeve të mjedisit VNM, Ndotja e ajrit, Mbrojtja e Mjedisit, Biodiversiteti dhe Menaxhimi i mbetjeve ku propozohet rritja e gjobave. Ai shprehet se: jam për një Shqipëri të pastër, por me ligje që konsultohen realisht me publikun, që nuk e rëndojnë xhepin e publikut, me ligje që u shërbejnë qytetarëve dhe jo qeveritarëve
	3		Diskutim në komision dt. 10.2.2025 për projektligjin “Paketa e maleve”. Pro zhvillimit të zonave malore, por duke vendosur kriteret të qarta për pëfiruesit.
	3	Transport	Diskutim në seancë plenare dt. 10 shkurt 2025 në lidhje me projektin e rrugës, që është në interes të të

	3	Bujqësi	gjithë qytetarëve, Elbasan-Qafë Thanë, i cili prek një fshat të tërë, ku mbi 30 shtëpi i shkatërron, ndërkohë që ekziston mundësia që kjo rrugë të ketë një zgjidhje tjetër alternative, me tunel. Kjo do të kursente tokën bujqësore e cila do jetë në funksion të prodhimit bujqësor.
	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 25.2.2025 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor””. Subvencionim për bujqësinë. Diskutim në seancë plenare dt. 27 shkurt 2025 në lidhje me mbështetjen e infrastrukturës së ujitjes për zonat e Librazhdit me qëllim mbështetjen e fermerëve dhe prodhimit bujqësor në këto zona, duke mundësuar kështu një bujqësi të qëndrueshme.
Pyetje në aktivitete/ Komisione/ seancë (2)	8	Transport	Pyetje (5) në komision dt. 16.7.2024 për projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve për linjën hekurudhore Vorë – Hani i Hotit – Porta globale”.
	8	Transport	Pyetje (4) në komision dt. 10.12.2024 për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare, sh.a.”
	10	Transport	Pyetje (5) në komision në dt. 22.1.2025 . Marrëveshje kredie për “Hekurudhat shqiptare, rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë- Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.
	8		Pyetje (4) në komision dt. 10.2.2025 për projektligjin “Paketa e maleve”.
	8	Bujqësi	Pyetje (4) në komision dt. 25.2.2025 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor””.

Interpelanca (3)			
Ftesë për dëgjesa të Shoq. Civile (2)			
Amendamente (4)			
Nisma ligjore (5)			

Fadil Nasufi

KRITERI	PIKËT	FOKUSI	ARGUMENTIM
Pjesëmarrja në mbledhje/ aktivitete (1)			
Diskutimi në aktivitete/ komisione/ seancë (3)	3	Bujqësi	Diskutim në komision dt. 4.9.2024 për projektligjin për veterinarinë në cilësinë e relatorit, ku shprehet se nëse do të kemi produkte mjekësore veterinare me cilësi të dobët, kjo do të çojë në dështim të sigurimit të shëndetit të kafshëve dhe rrjedhimisht në pasoja për sigurinë ushqimore dhe për shëndetin e njerëzve dhe pa dyshim edhe në rritjen e kostove për kujdesin shëndetësor.
	3	Klima/ Mjedis	Diskutim në komision për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me Republikën Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2022 për projektin “Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri”. Pa dyshim që është një nga projektligjet me një ndjeshmëri të lartë

			globale, siç janë problemet e klimës dhe në përgjithësi problemet që kanë të bëjnë me mjedisin që, siç e tha edhe zoti Pëllumbi, ne jemi dyfish të interesuar, sepse jemi anëtarë të Grupit të Gjelbër. Diskutim në komision dt. 15.10.2024 për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar”. U shpreh se thelbi i ligjit është forcimi i masave të zbatimit të ligjit deri në rritjen e gjobave, ekzekutimin e gjobave apo edhe në revokimin e lejeve. Diskutim në komision dt. 29.10.2024 për projektligjinm “Për disa ndryshime në ligjin për fondin kullosor”. Relator ku u shpreh se ndryshimet bëhen për t’i hapur rrugë veprimtarisë për lejimin e investimeve për prodhimin e energjisë së rinovueshme edhe në fondin kullosor. Kjo nevojë vjen nga zbatimi i politikave që ka qeveria për sigurimin e energjisë së pastër nga burimet e rinovueshme, nëpërmjet parqeve eolike dhe fotovoltaike; së dyti, nga prirja globale për diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë së rinovueshme; së treti, nga nevoja që ka vendi ynë për të prodhuar energji të rinovueshme dhe për të garantuar një 6 treg të qëndrueshëm dhe të pavarur energjie, deri në krijimin e mundësive edhe për të eksportuar energji, si vend prodhues, të paktën me objektiv deri në vitin 2030 Diskutim në komision dt. 6.11.2024 për projektbuxhetin 2025 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Diskutime për rrjetin rrugor. Diskutim në seancë dt. 17 tetor 2024 për projektligjin ndryshues të ligjit për shërbimin veterinar. Këto ndryshime do të kenë impakt të drejtpërdrejtë te shëndeti i kafshëve dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë i shërbejnë edhe shëndetit të njerëzve, kanë impakt në ruajtjen e mjedisit, si dhe ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve dhe në reduktimin e ndotjes.
	3	Energji	
	3	Energjia	
	3	Bujqësi	Diskutim në seancë dt. 31 tetor 2024 për projektligjin ndryshues të ligjit “Për fondin kullosor”. Ndryshimet

	3	Transport/ Bujqësi	kërkojnë që t’i hapet rrugë lejimit të investimeve për prodhimin e energjisë së rinovueshme, nëpërmjet instalimit të parqeve eolike dhe fotovoltaike në sipërfaqet e fondit kullosor. Përfshirja e fondit kullosor edhe për qëllime të prodhimit të energjisë së rinovueshme nuk është tjetërsimi i kullotave nga funksioni i tyre bujqësor dhe blegtoral, por funksioni i dyfishtë, ku përfshihet bashkëjetesa edhe me këtë aktivitet të ri.
	3	Transport	Diskutime në séancë dt. 7 nëntor 2024 për Buxhetin Faktik 2023. Ai foli për një trend të pandalshëm investimesh private në agroturizëm, në bujtina, në hoteleriturizëm, në njësitë akomoduese dhe në çdo fushë që dikton fluksi turistik në rritje Diskutime në séancë dt. 18 – 19 nëntor 2024 për projektbuxhetin 2025. Investimet më të mëdha publike ka në infrastrukturë, në rrjetin e rrugëve kombëtare dhe ndërkombëtare, në hekurudha, në porte dhe aeroporte, në arsim, në shëndetësi, në teknologji dhe inovacion, në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe përpunimin e ujërave të ndotura, në turizëm, në bujqësi, në mjedis e të tjerë.
	3	Transport/ Bujqësi/ Mjedis	Diskutim në komision në dt. 10.12.2024 për projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”. Mendoj se kjo është një reformë që duhet të ndodhë, sepse është në agjendë me “Paketën e gjelbër” dhe me direktivën europiane për trajtimin e qëndrueshëm dhe riciklimin e mbetjeve. Sa më shumë të vonojë, aq më shumë rriten efektet negative të ndotjes në mjedis, por edhe kostot financiare
